



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1231 / Prot.
11

Tiranë, më 22/05/2023

VENDIM

Nr. 14, datë 22.05.2023

PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, Vendimin Nr. 243, datë 20.04.2023 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, ‘Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Vendimin Nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 9, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit Nr. 1231 Prot., datë 18.05.2023, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.05.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për ndryshimin e nivelit të pagave të personelit akademik në Universitetin Politeknik të Tiranës, në kufirin maksimal të përcaktuar për funksion/titull në vendimin nr. 243 datë 20.04.2023 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748 datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, kolona 3, lidhja 1, duke filluar nga data 1 prill 2023.
2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

Në mungesë dhe me porosi

ZV. REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundo